

Në mbështetje të nenit **12 të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës dhe neneve 18 e 34 të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës**, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e vet të mbajtur më 4 korrik **2006**, nxjerr

## **R R E G U L L O R E N**

### **MBI VEPRIMTARINË BOTUESE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

#### **Neni 1**

Veprimtarinë e vet botuese Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës (në tekstin e mëtejshëm: Akademia) e bën përmes edicioneve të veta.

Në edicionet e veta Akademia i boton punimet e anëtarëve dhe të bashkëpunëtorëve të vet, si dhe të punonjësve të tjerë shkencorë dhe të arteve.

#### **Neni 2**

##### **Akademia boton:**

##### **1. Vepra shkencore:**

a) Veprat e anëtarëve të Akademisë dhe të punonjësve të tjerë të shkencës mbi çështjet që parashihen me planin afatgjatë kërkimor-shkencor, pa marrë parasysh se a janë hartuar në Akademi apo jashtë saj;

b) Veprat e anëtarëve të Akademisë, që janë rezultat i punës së tyre të pavarur shkencore rreth çështjeve që nuk parashihen me planin afatgjatë kërkimor-shkencor të Akademisë;

c) Veprat e punonjësve të tjerë të shkencës, që kanë vlerë të posaçme dhe rëndësi afatgjatë për Kosovën e më gjerë.

##### **2. Botime kritike, letrare e artistike.**

##### **3. Materiale me rëndësi për shkencën dhe artin.**

#### **Neni 3**

Për veprimtarinë botuese të Akademisë kujdeset Këshilli redaktues i Kryesisë, në krye me Sekretarin e Përgjithshëm të Akademisë.

#### Neni 4

Akademia i boton këto seri të edicioneve të veta:

1. “*Vjetari*”, që del një herë në vit dhe ku botohen të dhënat themelore, dokumentet me rëndësi dhe raportet mbi punën e Akademisë.

2. “*Kërkime*”, organ i seksioneve të Akademisë, ku botohen punime shkencore dhe punime të fushave të tjera të arteve, si dhe vështrime kritike dhe rezultate të arritura në shkencë dhe art.

3. “*Libërshënuesi*” i Kryesisë ose i seksioneve, në të cilin botohen materiale për ngjarje me rëndësi për Akademinë.

4. Materiale të tubimeve shkencore të Akademisë, ku botohen në tërësi ose në formë fragmentesh punimet e paraqitura në tubimet shkencore të Akademisë.

5. “*Studime*”, në të cilën botohen punime kërkimore-shkencore.

6. “*Botime të veçanta*”, ku dalin në dritë shkrime shkencore nga të gjitha degët, të cilat nuk janë përfshirë në seritë e mësipërme.

7. “*Bibliografia*”, ku, me vendim të posaçëm të Kryesisë, botohen bibliografitë e anëtarëve të Akademisë.

8. Me qëllim përparimi të degëve të ndryshme të shkencës ose të arteve, seksionet mund të nxjerrin revista vetë dhe në bashkëpunim me institucione të tjera shkencore.

Në “*Vjetari*” ose në “*Kërkime*” mund të botohen edhe ligjëratat që mbahen në Akademi.

#### Neni 5

Seritë e reja të botimeve të Akademisë i institucionalizon Kuvendi i Akademisë, me propozimin e Kryesisë.

#### Neni 6

Edicionet e Akademisë, sipas rregullit, botohen në gjuhën shqipe ose në gjuhën angleze, shoqëruar me rezyme në gjuhën tjetër, përkatësisht shqipe.

Çdo punim që botohet në edicionet e Akademisë duhet të ketë patjetër edhe rezymenë në njërin prej gjuhëve botërore (anglisht, frëngjisht ose gjermanisht), përveç veprave të krijimtarisë artistike.

Me propozimin e seksionit përkatës të Akademisë, trajtesat dhe artikujt mund të botohen edhe në gjuhë të huaja, e për këtë vendos Kryesia e Akademisë.

Në rastet si më sipër, autori i trajtesës ose i artikullit është i detyruar të paraqesë përmbajtjen e gjerë në gjuhën shqipe.

### **Neni 7**

Edicionet e përhershme të Akademisë shtypen në formatin e zakonshëm, me shkronja të rëndomta dhe rrallorë të rëndomtë, në lidhje brosh gjysmëkartuçi të kopertinave. Me rastin e shtypjes së botimeve ose të edicioneve të tjera me kontribute të arteve figurative, për formatin vendos Kryesia e Akademisë, duke mbajtur parasysh zgjidhjet bashkëkohëse nga kjo fushë.

Edicionet e Akademisë shtypen, zakonisht, në 500 ekzemplarë, me përjashtim të veprave muzikore me partitura, simfoni e kantata e të tjera, të cilat shtypen në 300 ekzemplarë.

Tirazhin e botimeve të përmendura e cakton Kryesia e Akademisë në bazë të propozimit të seksioneve dhe të Këshillit redaktues.

### **Neni 8**

Çdo edicion i Akademisë, në kopertina, në faqen e parë e të dytë, si dhe në pjesën e sipërme, duhet ta ketë të shënuar emrin e Akademisë shqip dhe latnisht, në të cilin shënohet titulli ose lloji i botimit me numrin e serisë, e nën të shënohet emri i seksionit, me numrin rendor të edicionit.

Në faqet e titujve (të parën dhe të dytën) të çdo edicioni vihen emrat e recensuesve.

Nëse vepra (ose punimi) botohet me ndihmën e institucioneve të tjera jashtë Akademisë apo botimi i saj bëhet me ndihmën e tyre, kjo do të shënohet në një prej faqeve përkatëse të botimit.

### **Neni 9**

Dy ose më shumë seksione, në bazë të marrëveshjes, mund t'i propozojnë Kuvendit të Akademisë që të nxjerrin botime të përbashkëta.

Për botimet e këtilla, redaktorin e caktojnë seksionet e interesuara.

Mund të propozohen edhe botime edicionesh të përbashkëta të Akademisë me akademitë e interesuara të shkencave dhe të arteve. Lidhur me këtë, në bazë të propozimit të seksioneve përkatëse, pëlqimin e jep Kuvendi i Akademisë.

### **Neni 10**

Çdo botim të Akademisë e redakton redaktori i caktuar.

Sipas rregullit, Sekretari i Përgjithshëm është kryeredaktor dhe redaktor përgjegjës i botimeve të Kryesisë, ndërsa sekretarët e seksioneve, respektivisht udhëheqësit e këshillave dhe të komisioneve janë redaktorë të botimeve që i përgatisin ato.

Kryesia mund të vendosë që për disa botime ose seri, përveç redaktorit, të emërohet edhe Këshilli Redaktues.

### **Neni 11**

Çdo seri e edicionit të Akademisë mban numeracionin e Akademisë, të shënuar me numra romakë dhe numeracionin e seksionit, të shënuar me numra arabë.

Kopertinat, faqja e parë dhe e tretë e edicioneve, shkruhen në gjuhën shqipe, ndërsa faqja e dytë, sipas rregullit, në gjuhë të huaj.

### **Neni 12**

Dorëshkrimet e përgatitura përfundimisht për shtyp, i paraqiten Akademisë në disketë apo CD të radhitura në kompjuter me rrallorë përkatës dhe në faqe të plotë, të pajisura e të shoqëruara, patjetër, me të gjitha shtojcat (fotografitë, hartat, skicat, grafikonet, tabelat, treguesi i emrave etj.), pastaj me regjistrat, rezymenë përkatëse në gjuhën shqipe dhe me rezymenë në njërën prej gjuhëve botërore.

Vlerësimin se vepra i përmbush kushtet për botim si edicion i Akademisë e bën, me propozimin e seksionit, Këshilli Redaktues i Akademisë.

### **Neni 13**

Dorëshkrimet e punimeve, përkatësisht të veprave të autorëve, i paraqiten Akademisë përmes administratës në adresë të seksionit

përkatës, bashkë me deklaratën e autorit se punimi në fjalë nuk është botuar apo është botuar pjesërisht.

Në deklaratën e autorit duhet të saktësohet përqindja e dorëshkrimit të pabotuar.

#### **Neni 14**

Dorëshkrimet e arritura i parashtron sekretari i seksionit përkatës në mbledhjen e parë të rregullt të seksionit, ku caktohen dhe recensuesit.

#### **Neni 15**

Që të propozohen për botim dorëshkrimet e anëtarëve të Akademisë, nevojiten:

a) dy referate të veçanta pozitive, ndërsa njëri prej referuesve duhet të jetë anëtar i Akademisë;

b) një referat pozitiv, nëse atë e shkruan anëtari i Akademisë, specialist për çështjet që trajtohen në tekstin e paraqitur.

Për botimin e dorëshkrimeve të autorëve që nuk janë anëtarë të Akademisë nevojiten dy referate të veçanta pozitive, me kusht që njëri prej referuesve të jetë anëtar i Akademisë.

Seksioni përkatës mund ta zgjedhë edhe recensuesin e tretë:

a) nëse këtë e shtron nevoja për recensionet e marra;

b) nëse këtë e kërkon autori i dorëshkrimit.

Nëse ndër anëtarët e Akademisë nuk ka specialistë për degë të caktuara të shkencës, atëherë në vend të recensuesve nga radhët e anëtarëve të Akademisë mund të zgjidhen recensues anëtarët e rregullt ose të jashtëm të ndonjëres nga akademitë botërore të shkencave e të arteve ose shkencëtarë përkatës të dalluar.

#### **Neni 16**

Propozimin se dorëshkrimi miratohet për botim e jep seksioni përkatës.

Vendimet e seksionit mund të jenë:

1. Dorëshkrimi pranohet për botim;
2. Dorëshkrimi i kthehet autorit që t'u përmbahet vërejtjeve që ia bëjnë recensuesit, eventualisht edhe seksioni;
3. Dorëshkrimi propozohet për t'u blerë si material;
4. Dorëshkrimi refuzohet.

### **Neni 17**

Nëse seksioni vendos që ta propozojë dorëshkrimin për botim, atë ia dorëzon Këshillit Redaktues të Kryesisë së Akademisë. Në vendim duhet të jepet arsytimi për llojin dhe rëndësinë e veprës, seria në të cilën do të botohet vepra, numri i ekzemplarëve dhe emri i redaktorit.

### **Neni 18**

Këshilli redaktues i Kryesisë ia shfaq mendimin e vet Kryesisë për futjen e dorëshkrimit në planin botues të Akademisë.

Këshilli Redaktues, para se ta shfaqë mendimin, mund të kërkojë nga seksioni edhe arsytimin plotësues të propozimit.

### **Neni 19**

Në bazë të propozimit të Kryesisë, Kuvendi i Akademisë merr vendim për ta futur dorëshkrimin në planin botues të Akademisë.

### **Neni 20**

Veprat e marra për botim seksioni ia dërgon redaktorit teknik, i cili së bashku me autorin i zgjidh të gjitha çështjet teknike rreth përgatitjes së veprës për botim dhe lidhur me rezydenë në gjuhë të huaj.

### **Neni 21**

Veprat e pranuar për shtyp si edicione të Akademisë, i shtrohen korrekturës gjuhësore, nëse seksioni, përkatësisht Këshilli Redaktues i Kryesisë nuk vendos ndryshe.

Korrekturën gjuhësore e bëjnë lektorët, regjistrin e të cilëve e përcakton Këshilli Redaktues i Kryesisë.

Autori vihet në dijeni me ndërhyrjet e lektorit.

### **Neni 22**

Në faqen e titullit të botimeve të veçanta, përveç të dhënave të përhershme, shënohen patjetër edhe emrat e redaktorëve përgjegjës, të recensuesve, të lektorëve dhe të korrektorëve.

### **Neni 23**

Shtypja e veprave që i boton Akademia, sipas kushteve të parapara me këtë Rregullore, bëhet pasi të lidhet kontrata për botim.

Në kontratë përfshihen këto elemente:

1. Emri dhe adresa e kontraktuesve;
2. Titulli i veprës që botohet;
3. Vëllimi i veprës në tabakë autori, respektivisht për nga numri i faqeve;
4. Regjistri i shtojcave;
5. Shuma, mënyra dhe afati i pagimit të honorarit të autorit;
6. Lloji i edicionit në të cilin do të botohet vepra;
7. Numri i ekzemplarëve të botimit;
8. Numri i ekzemplarëve që i jepen autorit pa kompensim dhe dispozitat mbi shtypjen e veçantë.

Kontratën, në emër të Akademisë, e nënshkruan Sekretari i Përgjithshëm i Akademisë.

### **Neni 24**

Me kontratat nga neni i mësipërm, Akademia nuk mund të obligohet lidhur me afatin për kryerjen e shtypjes.

Me kontratë duhet të parashihet që shpenzimet për ndryshimin e tekstit, të cilat bëhen gjatë shtypjes së veprës, t'i heqë personi që i bën ato. Vendimin mbi shmangien nga kjo dispozitë mund ta marrë Kryesia, në rastet përjashtimisht të arsyeshme.

### **Neni 25**

Autorët e veprave të botuara si edicion i Akademisë, nuk mund të japin lejen për botimin e veprave të veta para se të mos ketë mbetur asnjë ekzemplar i veprave të tyre që i boton Akademia.

Akademia ka përparësi që të nxjerrë botim tjetër, e për këtë vendos në afatin prej një muaji, nga dita kur i kumtohet autorit se s'ka mbetur më asnjë ekzemplar nga botimi i parë.

### **Neni 26**

Sipas rregullit, Akademia nuk i rishtyp punimet që janë botuar në tërësi. Konsiderohet se vepra nuk është botuar më parë, nëse është botuar më së shumti 25% e tekstit të saj.

Vendimin mbi mospërfilljen e rregullave të paragrafit të mësipërm mund ta marrë Kryesia e Akademisë, me propozimin e seksionit, vetëm në rast se është fjala për ndonjë vepër jashtëzakonisht të rëndësishme dhe aktuale.

#### **Neni 27**

Honoraret e autorit dhe honoraret e tjera rreth përgatitjes së edicioneve të Akademisë përcaktohen me rregullore të veçantë.

Rregulloren mbi honoraret e veprimtarisë botuese të Akademisë e nxjerr Kryesia e Akademisë.

Kryesia, në bazë të propozimit të seksioneve, merr vendim për shtimin e honorarit deri në 50% për veprat e vëllimit të vogël, që kanë rëndësi për rezultatet e tyre dhe që kërkojnë një punë afatgjatë.

#### **Neni 28**

Me qëllim të nxitjes së punës shkencore dhe artistike, si dhe të prezentimit të rezultateve të veprimtarisë së vet, edicionet e veta Akademia mund t'i këmbëjë, t'i japë pa kompensim dhe t'i shesë me çmim të ulur.

#### **Neni 29**

Botimet e veta Akademia i këmben me të akademive të shkencave, të shoqatave shkencore, të institucioneve shkencore, të universiteteve, të fakulteteve dhe të organizatave të tjera shkencore-kulturore të vendit dhe të botës së jashtme, në baza reciprociteti.

Këmbimi mund të bëhet qoftë sipas parimit, të gjitha punimet e Akademisë me të gjitha botimet e institucioneve me të cilat bëhet këmbimi, ose libri me libër, pa marrë parasysh vlerën e tyre, apo libri me libër, sipas vlerës.

Këmbimi mund të kufizohet, në bazë të marrëveshjes paraprake, vetëm në disa degë ose në botime të caktuara.

Këmbimi bëhet me vendimin e Kryesisë.

Shërbimin e këmbimit të botimeve të Akademisë e udhëheq biblioteka e Akademisë.



### **Neni 30**

Nga një ekzemplar të çdo botimi Akademia ua jep pa kompensim:

- a) të gjithë anëtarëve të vet në përbërje të rregullt dhe të nderit,
- b) Ministrisë së Arsimit, të Shkencës e të Kulturës,
- c) Bibliotekës Kombëtare dhe Universitare të Prishtinës,
- ç) Bibliotekës Kombëtare Tiranë,
- d) Bibliotekës së Institutit Albanologjik të Prishtinës,
- dh) Bibliotekës së Institutit të Historisë të Kosovës,
- e) Akademive me të cilat bashkëpunon ASHAK,
- f) bibliotekave përkatëse të fakulteteve të Universitetit të Prishtinës.

Këtyre botimeve u vihet klauzola “Dhurim i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës”.

### **Neni 31**

Me kërkesën e institucioneve ose të individëve të interesuar, në bazë të vendimit të Kryesisë, publikimet e Akademisë mund t’u jepen pa kompensim edhe:

- a) bibliotekave, arkivave, institucioneve shkencore e të tjera brenda vendit dhe në botën e jashtme;
- b) bibliotekave rajonale të Kosovës;
- c) punonjësve të shkencës dhe të arteve brenda dhe në botën e jashtme, që merren me punë shkencore ose me qëllim prezentimi;
- ç) redaksive të revistave të njohura botërore referale në bazë të vendimit të seksioneve;
- d) individëve, të cilët i kontribuojnë në çfarëdo mënyrë qoftë përmes detyrave të Akademisë.

### **Neni 32**

Anëtarëve të vet të rregullt dhe korrespondentë dhe atyre jashtë trupit të përhershëm të punës Akademia ua jep pa kompensim nga një ekzemplar të “Vjetarit”, të “Libërshënuesit” dhe të edicioneve të tjera që i cakton Kryesia.

### **Neni 33**

Autorëve të veprave të botuara si edicion i Akademisë u takojnë pa kompensim nga 30 ekzemplarë të botimeve, që nxirren si edicion i veçantë.

Nëse vepra botohet si kontribut brenda edicionit përmbledhës, ajo autorëve u takon pa kompensim:

- a) nga një ekzemplar i botimit përmbledhës çdo autori dhe koautori të kontributeve,
- b) nga 30 separate punimesh të autorëve të caktuar,
- c) nga 15 separate punimesh, nëse është fjala për dy ose më shumë autorë.

Secilit redaktor i takon nga një ekzemplar i botimit të cilin e redakton.

Nga një ekzemplar u takon edhe: lektorit, recensuesit.

### **Neni 34**

Të gjitha seritë e edicioneve të Akademisë shiten drejtpërdrejt në Akademi ose përmes rrjetit librar.

Shitja bëhet me çmime, të cilat i cakton Kryesia e Akademisë.

Librarive u lejohet marzhi i rëndomtë ose i kontraktuar, të cilin e përcakton Kryesia e Akademisë.

### **Neni 35**

Botimet e Akademisë mund t'u shiten edhe me ulje të çmimit deri në 50%, në raste të arsyeshme, institucioneve dhe individëve, në bazë të kërkesës së tyre të arsyetuar me shkrim.

### **Neni 36**

Në rezervat e tirazhit, me vendim të posaçëm të Kryesisë, institucioneve të ndryshme, mund t'u shitet një numër sosh, por dhjetë copë do të ruhen.

### **Neni 37**

Për zbatimin e kësaj Rregulloreje përkujdeset Kryesia dhe Këshilli Redaktues i Akademisë.

### **Neni 38**

Kjo Rregullore hyn në fuqi ditën e nesërme, pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë.

### **Neni 39**

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja mbi veprimtarinë botuese të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës nxjerr nga Kuvendi i ASHAK më 2 prill 1998.

## **KUVENDI I AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS**

**SEKRETARI I PËRGJITHSHËM      KRYETARI I AKADEMISË**

**Akademik Hivzi Islami, d.v.      Akademik Rexhep Ismajli, d.v.**